



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 15 DHJETOR 2014**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 15. DECEMBRA 2014. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2014**

Rendi i ditës

1. Miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare

Dnevni red

1. Usvajanje predloga odluke o formiranju parlamentarnih komisija

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Përshëndetje të nderuar deputetë,
Të pranishëm janë 95 deputetë, andaj fillojmë me punimet e mbledhjes plenare.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3, dhe nenin 42 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Të nderuar deputetë, procedojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare

Të nderuar deputetë,
Në pajtim me nenin 15, paragrafi 1, neni 63 i Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ia ka propozuar Kuvendit për miratim numrin dhe strukturën e komisioneve parlamentare.

Janë propozuar 14 komisione parlamentare, prej tyre 4 janë komisione të përhershme dhe 10 janë komisione funksionale.

Propozim-vendimi për numrin dhe strukturën e komisioneve parlamentare u është shpërndarë deputetëve.

Të nderuar deputetë,
Në ndërkohë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosja” i ka propozuar deputetët, pastaj Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim i ka 12 anëtarë, gjersa ndërkohë janë propozuar 14 anëtarë, domethënë i kemi 2 më shumë. Një anëtar nga komunitetet, përkatësisht ashkali, egjiptian dhe rom duhet të tërhiqet nga komisioni, si dhe një anëtar nga komuniteti shumicë po ashtu duhet të tërhiqet nga komisioni. Domethënë, janë 14 aktualisht (2 më shumë), prandaj dy duhet të tërhiqen.

Po ashtu, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka propozuar gabimisht për zëvendëskryetar në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeten Sala Berisha-Shala. Ky post i takon Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Mund të kërkohet deklarimi e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Unë do të shkoj në bazë të radhës së përfaqësimit. E ftoj, në qoftë se dëshiron, Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Atëherë, e ftoj Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!
Përshëndetje për kryeministrin dhe për Kabinetin qeveritar,

Ne kërkojmë që në Komisionin për Komunitete, ashtu e kemi propozuar, por kërkojmë të mbetet si përfaqësues i komunitetit egjiptian, që është hera e parë në të gjitha legjislaturat, që ky komunitet ka shans, ka gjasa dhe do të duhej të përfaqësohej si komunitet i tillë dhe po e përsëris - ne kërkojmë, jo vetëm si grupi i dytë parlamentar, por edhe nga fakti se ky në këtë rast është në grupin tonë, por e përfaqëson komunitetin egjiptian.

Dhe, të gjithë ata që janë në dy komisione e më tepër duhet të lëshojnë rrugë, e të tillë ka nga komunitetet tjera që janë në më shumë komisione sesa në një.

Prandaj, në të vetmin vend që ne e kemi propozuar, përkatësisht në komision zotin Berisha, në këtë rast, është në Komisionin për Komunitete, edhe nga fakti se e përfaqëson edhe komunitetin egjiptian. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”!

VISAR YMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Fillimisht më duhet të them që edhe në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, e cila ka qenë e zgjeruar edhe me përfaqësues të grupeve parlamentare, ne e kemi shprehur pakënaqësinë tonë për mënyrën se si ndahen komisionet dhe veçanërisht për këtë përbërje të Kuvendit në Legjislacionin e Pestë, meqë i është bërë një padrejtësi e madhe edhe funksionimit të Kuvendit, edhe rolit të tij shumë të rëndësishëm të mbikëqyrjes edhe monitorimit të punës së Qeverisë, dhe atë në ndarjen dhe mënyrën se si janë ndarë këto komisione me kryesim, por edhe me numrin e anëtarëve që i përbëjnë këto komisione.

Për sa i përket Lëvizjes “Vetëvendosje”, ne e kemi dorëzuar me vonesë listën me anëtarë, të cilën ju e keni përpara dhe nuk besoj që ka nevojë për t’i lexuar të gjithë emrat tash, meqenëse janë të shkruar. Por, vetëm dua edhe një herë ta theksoj përmirësimin që u bë, që nënkryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik i takon Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe, në anën tjetër, në Komisionin për Punë të Brendshme është përvjedhur një gabim në letrën që është dorëzuar nga Lëvizja “Vetëvendosje”. Ne e kemi anëtarin, e jo nënkryetarin, pra edhe pse shkruan aty, është gabimisht.

Dhe, meqenëse ka pakënaqësi në ndarjen e komisioneve do të kisha kërkuar që sot të kemi, përveç deklarimeve të përfaqësuesve të grupeve, edhe debat, pra mundësi që deputetët të deklarohen për këtë çështje dhe pas kësaj të hidhet në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Po ashtu, vërejtjet tona i dhamë në Kryesi. Ne konsiderojmë që kjo formulë e ndarjes, e cila po aplikohet dhe po praktikohet 1,5,7,9, në fakt nuk e avancoi demokracinë. Është thanë në të gjitha periudhat, edhe në të kaluarën, jo vetëm nga brenda e Kosovës, por edhe në Raportin e Progresit që Kuvendi në vazhdimësi po ngec me mbikëqyrjen e Ekzekutivit, e kjo ka mundur të përmirësohet në këtë legjislacion, ashtu siç kemi propozuar në takimin e Kryesisë, duke na dhënë mundësi që një herë të zgjedhë pozita -

një herë opozita. Kjo do të ishte më demokratike. Ne jemi të vetëdijshëm për numrin e komisioneve, mirëpo për cilësinë është dashur të jetë një përzgjedhje tjetër.

Megjithatë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës i ka dorëzuar me kohë të gjitha emrat dhe qëndrojmë pranë tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar Lista serbe! Nuk ka. Grupi Parlamentar “Nisma”!

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar “Nisma” mbështet parafolësit e opozitës, sikur Visarin, ashtu edhe Donikën, gjë që e kemi shprehur edhe në ditën e mbledhjes - mospajtimet me renditjen, ose me ndarjen e komisioneve.

Po ashtu, edhe sot po e shprehim një shqetësim, sepse ku kryetarët e komisioneve funksionale janë të pozitës, atë ditë kemi kërkuar që nënkryetarët të jenë të opozitës, gjë që nuk na është aprovuar, duke e ditur që edhe si numër jemi pak, mirëpo kërkesa jonë nuk është marrë parasysh.

Por, edhe sot, pasi është seancë e rregullt, është dashur që rendi i ditës, ose të jetë si pikë e rendit të ditës edhe deklarimi i deputetëve për vazhdimësinë e seancës. Mirëpo, kjo ishte vetëm një pikë e rendit të ditës. Kështu që edhe “Nisma” e përkrah propozimin e Donikës, po ashtu edhe të Visarit, mirëpo emrat të cilët i kemi dërguar të “Nismës” qëndrojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar “6+”!

DUDA BALJE: Poslanici iz Parlamentarne grupe “6+”, onako kako nam je pripadalo po komisijama, podelili smo predlog na vreme sekretarijatu. Međutim mi sad u grupi imamo problem, ja sam to iznela i na Predsedništvu, oko člana iz Aškaljske zajednice, pošto smo imali pravo na jedan član iz Aškaljske zajednice u Komisiji za zajednice, on odbija da bude član u toj Komisiji, tako da ćemo imati problem s tim, znači sa grupom iz Roma, Aškaljie i Egipćana, i to se odnosi sad na članstvo Aškaljije iz Parlamentarnih grupe LDK.

Mi smo kao Parlamentarna grupa “6+” dobili da imamo predsednika Komisije za poljoprivredu, i to ćemo dati napismeno, a prvih 14 meseci odlučili smo da bude po sistemu rotacije, dobije ga poslanik iz turske zajednice, a onda do kraja mandata poslanik iz Bošnačke zajednice. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë jemi te Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim. I kemi 14 anëtarë. Ju lutem, dy duhet të largohen, është marrëveshje juaja ndërmjet deputetëve, njëri nga komuniteti shumicë edhe njëri nga komunitetet ashkali, egjiptian dhe rom. Duhet të ketë një marrëveshje në mënyrë që të procedojmë.

Zoti Grabovci!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë edhe në mbledhjen e Kryesisë me shefat e grupeve parlamentare kam shprehur mospajtimin tim me formulën për ndarjen e komisioneve, sepse grupet e mëdha parlamentare, ka deputetë të cilët mbeten pa përfaqësim apo pa përfshirje në komision, e dihet se deputetët punën, angazhim dhe kontributin e tyre e japin nëpërmjet komisioneve.

Megjithatë, ne e kemi pranuar atë formulë si të tillë edhe në këtë rast Blerta Deliu tërhiqet nga ky komision, edhe pse në vazhdimësi po na takon që të dëmtohem për interesa më madhore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë e kemi edhe një anëtar. Urdhëro, Danush!

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket një anëtari nga komuniteti shkali, egjiptian dhe rom që të tërhiqet nga ky komision, unë e shoh që nga këto tri komunitete duhet të përfaqësohen në këtë komision shumë të rëndësishëm për komunitete edhe me vetë faktin se ky komision është për komunitete, por nëse duhet të tërhiqet dikush nga komuniteti ashkali, egjiptian dhe rom, ne si ashkali nuk tërhiqemi, sepse numrin të popullsisë e kemi tri herë më shumë se egjiptianë, kurse pesë herë më shumë se romë, dhe jemi komuniteti numër një nga komunitetet RAE në Kosovë, dhe ne duhet të përfaqësohemi si komunitet.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, Veton Berisha!

VETON BERISHA: I nderuar, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Sinqerisht jam bërë pak i tepërt se po më duhet gati në çdo seancë të dal këtu. Por, në përgjithësi, prapë duhet ta shpreh shqetësimin tim, meqë unë nuk duhet të trajtohem më pak, ose më shumë se tjetri. Jam komunitet i njohur me Kushtetutë, dhe çdo e drejtë e cila mua më takon duhet të më takojë.

Jam detyruar në të gjitha mënyrat që unë të gjej pozitë dhe ta pozicionoj komunitetin egjiptian në një prej pozitave të mundshme në legjislacion. E dini shumë mirë, jam në Grupin Parlamentar të LDK-së, edhe nëpërmjet këtij grupi kam mbërri të jem në të vetmin komision, në atë për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Edhe zotërinjtë e nderuar, që tani këtu dalin dhe thonë që ne jemi më shumë ose më pak, kjo nuk është e shëndetshme edhe nuk na çon askund kjo. Por, kërkoj që unë, meqenëse jam në të vetmin komision, e zotërinjtë e nderuar janë në nga tri komisione, atëherë të mundësohet që edhe unë të jem pjesë e Legjislativit, edhe unë ta jap kontributin tim dhe të jem i përfaqësuar aty ku më ka dërguar komuniteti.

Kërkoj mirëkuptimin tuaj që kjo logjikë të akceptohet dhe të jem i nderuar që unë ta pranoj këtë detyrë edhe ta kryej me përgjegjësi. As unë nuk tërhiqem! Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, e kemi edhe komunitetin rom. A ka deklaram nga përfaqësuesi. Atëherë, nuk tërhiqet askush nga komunitetet pakicë. Ne do të vazhdojmë me rendin e ditës, do të bëjmë aprovimin e këtyre 13 komisioneve, të cilat janë të përfunduara. Në të njëjtën kohë, edhe për komisionin e 14-të komunitetet shumë votohen, pastaj do ta lëmë një mundësi që më vonë edhe 4 anëtarë nga komuniteti pakicë të kenë përfaqësimin, pasi duhet të ketë një kompromis të paktën ndërmjet tyre.

Arben, na e sqaro, se është fillimi, e kemi nevojë.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Deputetët nga radhët e komuniteteve gjithmonë mund të marrin pjesë nëpër të gjitha komisionet. Përkatësia në komision dallon vetëm me të drejtën e votës, kështu që është obligim edhe me Rregullore që secili deputet të jetë të paktën anëtar i një komisioni. Kështu që zoti Veton Berisha duhet të jetë në një komision, ndërsa nëse ka nga deputetët në radhët e komuniteteve që janë në disa komisione tjera, atëherë duhet të zgjedhin se në cilin komision duan të jenë. Nuk mund dikush të jetë në disa komisione dhe të ketë deputet që nuk është në asnjë komision.

Prandaj, le të sqarohet qartë: Deputetët kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjitha komisionet, kanë të drejtë të diskutojnë, por nuk e kanë të drejtën e votës, e para, dhe e dyta, deputetët duhet të marrin pjesë, përkatësisht të jenë anëtarë me të drejta të plota të paktën në një komision. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, edhe një herë, ne do të vazhdojmë në bazë të asaj - 13 komisione do të aprovohen sot, edhe komisioni i 14-të. Komunitetet pakicë duhet ta kenë një konsensus ndërmjet vete, në mënyrë që të votohen edhe 4 deputetët nga komuniteti pakicë. Një sqarim rreth vërejtjes së deputetes Bajrami nga Grupi Parlamentar "Nisma", pyetjet jashtë rendit të ditës do të jenë pas këtij konstituimi të sotëm të komisioneve parlamentare, se është e drejtë juaja.

Unë do të vazhdoj me diskutimet e deputetëve të cilët janë lajmëruar paraprakisht për këtë rend dite. E ftoj zotin Visar Ymeri. E ka përfunduar. Zoti Besnik Bislimi!

BESNIK BISLIMI: Të nderuar deputetë,

Sipas mendimit tim, momenti kulmor i seancës së 17 korrikut ka qenë betimi solemn i të gjithë neve. Ndërmjet tjerash, gjatë këtij betimi ne jemi besatuar që si deputetë të Kuvendit të Republikës të Kosovës me nder e përkushtim do ta kryejmë detyrën tonë dhe do të përfaqësojmë me dinjitet popullin, do të punojmë në interes të Kosovës, dhe tutje.

Një aktivitete kryesor nëpërmjet të cilit ne si deputetë e kryejmë detyrën tonë dhe i përfaqësojmë qytetarët tanë, është edhe puna nëpër komisione parlamentare. Sa më efikase të jetë puna e komisioneve parlamentare, aq më e suksesshme do të jetë edhe Qeveria gjatë alokimit dhe shpenzimit të parasë publike, andaj edhe synim parësor i Parlamentit do të duhej të ishte përforsimi kontinual i rolit të tij gjatë ushtrimit të këtij funksioni.

Nga konstituimi i Legjislacionit të Parë, gjatë ndarjes së komisioneve parlamentare është shfrytëzuar një praktikë, e cila ka synuar një shpërndarje më të barabartë të komisioneve ndërmjet pozitës dhe opozitës. Si rrjedhojë, në legjislacionin e kaluar ndarja ka qenë 7:6 në favor të pozitës, ndërkajë sa u përket komisioneve të përhershme 50:50, apo dy komisione për pozitën dhe dy për opozitën.

Meqë tani kemi koalicion të dy partive të mëdha, shfrytëzimi i të njëjtës formulë është krejtësisht i papërshtatshëm për përmbushjen e frymës me të cilën është operuar në legjislacionet e mëparshme. Si rrjedhojë, përdorimi i kësaj formule, në vend të forcimit të rolit të Kuvendit në monitorimin e punës së Ekzekutivit, ajo kontribuon në të kundërtën, duke e deformuar edhe më tej atë. Kështu, si pasojë e përdorimit të kësaj formule, ndarja e komisioneve e ka favorizuar fuqishëm pozitën dhe e ka kthyer ndikimin e partive opozitare vetëm në dekor parlamentar.

Tani partitë, pjesë e koalicionit, i kontrollojnë nominalisht 10 nga 14 komisionet parlamentare dhe 75% të komisioneve të përhershme. Ndërkajë, përmes alokimit të palogjikshëm të numrit të anëtarëve që secila parti delegon në punimet e komisioneve, në fakt partitë e koalicionit qeverisës dominojnë edhe në punën e atyre komisioneve që nominalisht drejtohen nga partitë opozitare.

Me qëllim që neve si deputetë të Kuvendit të Kosovës të na mundësohet veprimi në harmoni me betimin që kemi dhënë dhe në mënyrë që besimin e qytetarëve ta shpërblejmë me një monitorim sa më efektiv të Qeverisë, mendoj se na duhet një konsensus i përbashkët për daljen nga formula ekzistuese e ndarjes së komisioneve dhe adaptimi i një formule tjetër, e cila garanton një shpërndarje më adekuate të komisioneve, shpërndarje kjo e cila përkon më shumë me rolin tonë si deputetë.

Në këtë kontest peshë të veçantë ka edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, nëpërmjet të cilit do të duhej të monitorohej Qeveria gjatë vendimmarrjes për alokimin e shpenzimeve buxhetore në kategori të caktuara të caktuara ekonomike. Në këtë komision vjen në pah roli primar i deputetëve më mbikëqyrjen e punës së Ekzekutivit dhe në vendet me demokraci të avancuar, ky komision logjikisht i jepet apo i alokohet partisë më të madhe opozitare. Me rastin specifik të vendit tonë, rëndësia e këtij komisioni në ushtrimin funksionit të deputetëve rritet eksponencialisht.

Si rrjedhojë, e shfrytëzoj rastin që të apeloj te të gjithë deputetët, e para së gjithash te kolegët e mi nga dy partitë më të mëdha që të ridiskutohet puna e udhëheqjes në këtë komision dhe, rrjedhimisht, i njëjti t'i kalojë partisë opozitare. Jam shumë i bindur se një komision i tillë, apo një kostalacion i tillë do të mbështetej fuqishëm edhe nga qytetarët e vendit, që janë votuesit tanë, por edhe nga përfaqësues të shoqërisë civile. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Albulena Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Të nderuar qytetarë të Republikës,
Të nderuar deputetë,

Meqë zgjedhjet për Kuvendin e Republikës kanë për qëllim të shprehin dinamizmin e mendimit politik të qytetarëve si sovran të vetëm të Republikës, do të ishte i logjikshëm edhe dinamizmi i reflektimit parlamentar, respektivisht i Legjislativit të Republikës së Kosovës, pra Kuvendit. Por, që nga përfundimi i konstituimit të Kuvendit është duke u vërtetuar një fakt i padiskutueshëm, që kapja po vazhdon. Pra, e njëjta po ndodhë edhe me Kuvendin e Republikës.

Sot jemi këtu për të miratuar propozim-vendimin e Kryesisë së Kuvendit për formimin e komisioneve parlamentare dhe kapja është sinonim i parë i kësaj qeverisjeje, pra kontrolli total ndaj Kuvendit, shtypja ndaj Kuvendit.

Shpërndarja e drejtimit të komisioneve parlamentare tregon diskrepancën më të madhe në Kuvendin e Republikës në aspektin e përfaqësimit. Komisioni qeverisës, sipas formulës së Kryesisë së Kuvendit, kontrollon gjithsej 10 komisione nga 14 sosh, PDK-ja 4, LDK-ja 4 dhe dy minoritarët e koalicionit. Rregullorja e Kuvendit, neni 63, paragrafi 5 i Rregullores e thotë qartë se gjatë përcaktimit të drejtimit të komisioneve të Kuvendit, Kryesia do ta ketë parasysh ndarjen proporcionale sipas forcës politike të grupeve parlamentare. Ndërkaq, propozim-vendimi që na është sjellë për miratim vërteton se partnerët e koalicionit me këtë formulë i dominojnë absolutisht organet ndihmëse të Kuvendit. Ky është kontrolli që synohet të materializohet në bazë të marrëveshjes PDK-LDK.

Pra që Kuvendi i Kosovës t'i vihet në shërbim secilit veprim të Qeverisë dhe ndalesën e Kuvendit për cilindo iniciativë që ta kontrollojë Qeverinë. Krahës kuantitetit, partnerët e koalicionit u kujdesën edhe për rëndësinë e komisioneve. Me shumë apetit dhe me zell u kujdesën që komisionet e caktuara assesi mos t'i bien nën kontroll opozitës, siç është për shembull Komisioni për Punë të Jashtme, e po ashtu edhe ai për Buxhet dhe Financa. Ishin komisione të arta, njëri ishte i sikletshëm për shkak të përgjegjësisë së shefit ndaj tij, e tjetri ishte i rëndësishëm nga shkak i petkut profesional të kryeministrit dhe ministrit të tij të Financave. Pra, kjo kapje po e reflekton vazhdimësinë dhe thellimin.

Lëvizja “Vetëvendosje” do të angazhohet maksimalisht që gjatë këtij mandati, kur edhe do të fillojë edhe ndryshimi i stërvonuar i Rregullores, që medoemos të ndryshohet kjo praktikë, e cila po e jetëson defunksionimin e Kuvendit. Me këtë angazhim do të synojmë që Kuvendi ta ruajë autonominë institucionale dhe politike, e jo të bjerë pre e kontrollit qeveritar dhe e politikave ditore të klaneve të interesit. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Armend Zmaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kryetar i Kuvendit,

Kryeministër,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Realisht, ndarja e komisioneve i takon grupeve parlamentare, Kryesisë së Kuvendit, por mbi të gjitha i takon deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të vendosin se mbi cilën bazë

apo mbi cilën logjikë do të udhëheqin me punën dhe me rolin mbikëqyrës ndaj Qeverisë - ekzekutivit të vendit, por edhe ndaj trupave të tjerë ekzekutivë, siç janë bordet dhe agjencitë e ndryshme.

Në mandatin e kaluar është biseduar shumë gjatë për numrin e komisioneve dhe ka pasur një tendencë, që numri i komisioneve të shkojë duke u zvogëluar e jo duke u rritur. Dhe, kjo sot nuk ka ndodhur, kjo kryesi dhe shefat e grupeve parlamentare kanë rritur numrin e komisioneve, gjë e cila devalvon rolin mbikëqyrës të Kuvendit, por edhe nuk ndërton raport korrekt ndërmjet deputetëve dhe trupave ekzekutivë që raportojnë para këtyre komisioneve.

Andaj, kjo nuk përkon me logjikën e asnjë Kuvendi, asnjë Parlamenti demokratik, të cilët çdoherë mundohen që të kenë kufizim të numrit të komisioneve dhe jemi i vetmi Kuvend, pothuajse në rajon dhe në botë, që kemi numër kaq të madh të komisioneve parlamentare, si ato që i quajmë kryesore, por edhe këto funksionale. Po ta shikojmë Shqipërinë, i ka nëntë komisione parlamentare, apo Maqedoninë, apo këto vendet e rajonit, por edhe vendet që kanë numër më të madh të banorëve, siç është Bundestagu Gjerman dhe të tjera, pavarësisht që numri i deputetëve mund të ketë rritje brenda këtyre komisioneve.

Andaj, ne kemi parë edhe në praktikë, po e zë për shembull, Komisioni për Rend dhe Siguri dhe Komisioni që është për AKI-në, një komision i cili mbledhet vetëm për kurtuazi ndonjëherë dhe për të krijuar shpenzime financiare dhe nuk e ka rolin mbikëqyrës ndaj këtij institucioni, sepse vetë natyra e punës është e tillë.

Apo, ka edhe shumë komisione tjera, që në të kaluarën është biseduar që të fuzionohen dhe që Kuvendi të jetë praktik, por të jetë koherent mbi mbikëqyrjen e Ekzekutivit.

Andaj, unë mendoj që ju keni gabuar kur keni përcaktuar një numër të tillë. Është dashur një logjikë ndryshe, por siç po shihet, këtu i mungon vetëm edhe një komision për mbikëqyrjen e ministrive pa portofol, sepse nuk do të dimë se kujt do t'i përgjigjet ish-deputeti dhe ministri Hoxha para trupave ekzekutiv. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Ismail Kurteshi e ka fjalën.

ISMAIL KURTESHI: Të nderuar pjesëmarrës të kësaj seance,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Në nenin 69, pika 1 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës në lidhje me komisionet thuhet: Komisionet e pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit.

Lëvizja “Vetëvendosje” në zgjedhjet e fundit ka fituar rreth 14% të votave, kurse në komisionet parlamentare është përfaqësuar me rreth 10% të anëtarëve të saj, ose nga 138 anëtarë sa i kanë të gjitha komisionet, Lëvizja “Vetëvendosje” i ka vetëm 14.

Në nenin 69 të kësaj rregulloreje thuhet: Deputetët në parim mund të jenë anëtarë vetëm në një komision. Me çelësin aktual për ndarjen e komisioneve, disa grupeve parlamentare

u takojnë nga dy e më shumë komisione për secilin deputet, kurse jo të gjithë deputetëve të Lëvizjes “Vetëvendosje” i takon së paku të jetë anëtar i një komisioni.

Grupet më të mëdha parlamentare duke shfrytëzuar të drejtën, që të parët të zgjedhin komisionet që do t’i kryesojnë, në shumë raste i kanë zgjedhur komisionet që janë të lidhura me ministrinë që udhëhiqen nga bashkë partiakët e tyre. Kështu e kanë zbehur rolin bazë të komisioneve, që është mbikëqyrja e punës së ministrive.

Andaj, ne si Lëvizje “Vetëvendosje” kërkojmë, ashtu siç e parasheh Rregullorja, që përfaqësimi i “Vetëvendosjes” në komisionet parlamentare të jetë në përputhje me përfaqësimin politik të Lëvizjes në Kuvendin e Kosovës.

Nën 2, që të gjithë deputetët e Lëvizjes, po kjo vlen edhe për të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës, të kenë mundësi ta japin kontributin e tyre së paku në njërin komision, sepse ka më shumë anëtarë komisionesh se sa ka deputetë, janë 138 anëtarë të komisioneve, e jemi 120 deputetë. Prandaj, kjo mundësi ekziston, vetëm duhet të bëhet një rindarje më e drejtë.

Nën 3, opozitës t’i jepet përparësi në zgjedhjen e komisioneve, që do t’i udhëheqin.

Nën 4, të mos lejohet që edhe Ministria edhe komisioni të udhëhiqen nga njerëzit e të njëjtës parti dhe në fund, nën 5, në komisione të dërgohen deputetët që janë njohës të fushës përkatëse, sepse bazuar në listat që kemi marrë, është vërejtur se shpërndarja nëpër komisione nuk është bërë bazuar në njohuritë që i kanë deputetët dhe në profesionet e tyre. Madje, shumë udhëheqës të komisioneve absolutisht nuk kanë të bëjnë me punën dhe fushëveprimin e komisioneve përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit!

Zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Unë dola këtu para jush vetëm për ta uruar Kuvendin e Kosovës për Komisionin për Punë të Jashtme, ku 80% të anëtarëve të Komisionit nuk dinë anglisht, por, mbase kjo është bërë me qëllim nga grupet parlamentare, në mënyrë që ish- ministri i Jashtëm, zoti Hoxhaj dhe ministri aktual i Jashtëm, zoti Thaçi, t’i kryejnë punët pa u marrë vesh nga Komisioni.

Thjesht, kam një pyetje për kryetarin e Kuvendit - A keni planifikuar që Kuvendi të punësojë përkthyes personalë për këta deputetë? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Është pyetje sugjестive, nuk na takon neve, por as s’do të ketë përkthyes, se e dinë dhe e mësojnë. E ftoj deputetin Pal Lekaj.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

PAL LEKAJ: Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Sa u përket komisioneve, është e vërtetë që nëse duam të jemi dhe të funksionojmë në mënyrë demokratike, atëherë kjo i lihet opozitës që ta mbikëqyrë punën e Qeverisë. Por, ajo që mund ta them, u përmend se pse nuk janë fuzionuar dy komisionet: Komisioni për Punë të Brendshme dhe i ai i Sigurisë së FSK-së, mendoj që këto dyja, jo që është dashur të fuzionohen, por së pari është dashur të fuzionohet Qeveria e Kosovës, e jo t'i kemi 21 ministra apo ministri, dhe kjo na detyron që ndoshta për të funksionuar edhe më mirë, komisionet të kenë kontroll mbi Qeverinë.

Prandaj, meqë ne jemi deklaruar se do të formohet ushtria e Kosovës, ky komision duhet të jetë funksional dhe mendoj se e ka vendin aty ku është, por mendoj se ajo që duhet të punojmë, ta ndryshojmë rregulloren, me qëllim që opozita ta marrë rolin mbikëqyrës mbi Qeverinë dhe në komisionet përkatëse të dominojë opozita.

Prandaj, tani e kemi një rregullore përpara dhe mendoj që meqë i kemi dorëzuar edhe emrat, atëherë të hidhet në votim dhe të votohet. Faleminderit!

KRYETARI: Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedniče!

Uvaženi kabinet Vlade,

Kolege poslanici,

Nadam se da će napokon ovaj Parlament shvatiti da Parlamentarna Grupa “6+” ne predstavlja sve manjinske zajednice, kao što je to bilo u prethodnom mandatu i da veći to imaju privilegije po pitanju raspodela po parlamentarnim komisijama.

Apsolutno podržavam ovo što je gospodin Veton Berisha uradio ispred Egipćanske Zajednice. Nadam se da će predsednik Parlamenta shvatiti da demokratsko pravo svakog narodnog poslanika je da ide u onoj grupi u kojoj on želi. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Arsyeja pse e mora fjalën është që të kërkoj sqarime nga Sekretaria dhe nga kryetari i Kuvendit si autoritet final për interpretimin e Rregullores rreth shumicës së nevojshme për ndryshimin e një çështjeje që është e paraparë me Rregulloren, e kjo ka të bëjë me numrin e komisioneve.

Siç e dini, Rregullorja shumë qartë e përcakton se cilat komisione ekzistojnë në Kuvendin e Kosovës dhe në arsyetimin e përgatitur këtu në propozim-vendim thuhet që numri të zvogëlohet nga 16 në 14. Në fakt, ne e dimë të gjithë që në praktikë kemi pasur më pak komisione, gjithsej 13 në mandatin e kaluar. Në esencë, edhe sot, në seancën e sotme po tentohet që numri i komisioneve të ndryshohet. Pra, pyetja ime është: Meqenëse kjo është

çështje e paraparë me Rregullore, me cilën shumicë do të ndryshohet kjo pjesë e Rregullores, sepse, siç e dini, ajo ndryshohet vetëm me 2/3-at, pra duhen së paku 80 vota. Në qoftë se propozohet shmangie nga Rregullorja, edhe për atë duhen 80 vota.

Pra, me sa vota sot do ta ndryshojmë numrin e komisioneve? Do të ishte mirë që kjo të sqarohet për deputetët e Kuvendit të Kosovës, sepse, përndryshe, në qoftë se nuk merren 2/3-at e votave, atëherë ky numër nuk mund të ndryshohet. Së paku, unë ashtu e kuptoj. Në qoftë se është ndryshe, mund të na njoftojë Sekretaria. Do të ishte mirë që të gjithë deputetët ta dinë sot qartë se për çka po votohet, për ndryshim të Rregullores, gjë që në fakt nuk do të mund të bëhej pa propozim-amendamente konkrete për shmangie nga Rregullorja, apo për diçka tjetër dhe sa vota duhen për një gjë të tillë? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Profesor Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar,

Zoti kryeministër,

Kolegë të nderuar,

Unë dola të saktësoj edhe për Kuvendin, sepse deputetët e dinë, por edhe për pjesën e minoritarëve në komisione.

Letrat i keni përpara, bëjini analizat vetë! Unë mendoj që është mirë që të lexohen letrat gjithmonë, bile ato që janë të shkruara, për të bërë analizë.

U diskutua për një përfaqësim të një komuniteti në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim. Ju e dini që ky është një komision kushtetues, dhe si i tillë pastaj kalon dhe në Rregulloren e Parlamentit dhe e ka një përbërje specifike, treshe me nga 4 anëtarë.

Problemi ishte rreth përfaqësimit të komuniteteve që janë 5 kandidatë, e duhen 4. Unë po bëj analizë, komunitetet le të thonë çfarë të donë, le t'i lexojnë funksionet e veta ku janë, por unë po ju nënvizoj.

Kujtim Paçaku, që është anëtar i Grupit “6+”, që është rom, është anëtar i tri komisioneve: Komuniteteve, Integriteteve dhe Administratës etj.

Danush Ademi, që është ashkali, që është i grupit, pra “6+”, është në tri komisione, për Komunitete, për të Drejtat e Njeriut, bile në të tretin është edhe zëvendëskryetar.

Veton Hoxha nuk është në asnjë komision. Është po ashtu përfaqësues i një komuniteti, ose minoriteti, si të doni. Atëherë, le të mendojnë vetë këta për përfaqësimin, a janë të barabartë, a nuk janë dhe le të mendojnë për mbipërfaqësimin, sepse po të mos ishin kushtetutshmërisht të mbipërfaqësuar në Kuvend, nuk do të mund t'i kishin minoritetet nënkryetarët në të 14 komisionet e Kuvendit, i kanë minoritetet.

Prandaj, le të logjikojnë mirë për përfaqësimin. Unë them që në këtë rast nuk ka nevojë për perceptime dhe për shtyrje ndërmjet përfaqësuesve të komuniteteve është Kuvendi që

duhet të vendosë që asnjë deputet i tyre të mos mbetet pa përfaqësim, që zotëri Veton Berisha të jetë anëtar i këtij komisioni, ndërsa Grupi “6+” le të vendosë Paçakun ose Ademin, le të heqë, le t’i kanë nga 2 ose 3 përfaqësime. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, më lejoni paraprakisht, para se të kalojmë në procesin e votimit t’i bëj disa qartësime, të cilat kanë të bëjnë me procedurat të cilat janë ndjekur nga Kryesia e Kuvendit.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, neni 15, Kryesia në fillim të mandatit zgjedhor, në marrëveshje me grupet parlamentare e propozon numrin dhe strukturën e komisioneve parlamentare për të cilat vendos Kuvendi.

Do të thotë, gjithmonë deri tani jemi në fazën e propozimeve. Pastaj, më lejoni të theksoj se ndarja e komisioneve, po ashtu, është bërë në bazë të po kësaj rregulloreje, neni 63 pika 5.

Në të njëjtën kohë edhe përzgjedhja është bërë në bazë të Ligjit për zgjedhje.

Edhe një herë. Deputetja Blerta Deliu-Kodra e deshi fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Dola në foltore vetëm për t’u deklaruar se unë heq dorë nga Komisioni për Politikë të Jashtme. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe një herë! Për komunitetin pakicë, a ka reflektim, apo të vazhdojmë? Ju lutem, zoti Kujtim!

KUJTIM PAÇAKU: Faleminderit kryetar!

Edhe unë heq dorë nga Komisioni për Integritet Evropian. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, të nderuar deputetë, para votimit do t’i lexoj këshillat juridike për vendimmarrje.

Më fal, urdhëro Danush, se deri sa po flisja u paraqitët për diskutim.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryetar!

Unë tërhiqem nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, ku e ka edhe kolegun Veton Berisha, mund të shkojnë dorë për dore atje, kurse nga unë nga komunitetet do e mbaj, e nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut tërhiqem.

KRYETARI: Zoti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit! Atëherë, unë edhe kërkoj për ta sqaruar atë çështjen që e ngriti deputetja Osmani, që ka shumë të drejtë, që të dihet nga deputetët se cili është numri i saktë i votave që e miraton këtë propozim të Kryesisë, duke i pasur parasysh

rrethanat në të cilat jemi dhe po ashtu ajo referenca në Ligjin për zgjedhjet nuk po më duket se qëndron me këtë rast, sepse këtu po flasim për komisionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për strukturën, numrin dhe përbërjen e tyre, gjë që rregullohet, veçanërisht numri dhe struktura rregullohet në Rregulloren e Kuvendit, e jo në Ligjin për zgjedhjet.

Po ashtu, dua të deklaroj tash se ne do të votojmë kundër kësaj mënyre të ndarjes së komisioneve për shkak se jemi të pakënaqur me mënyrën se si janë ndarë këto dhe me çelësin që është përdorur, siç e përmend edhe nga deputetët që folën në këtë seancë për këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: A ka ende diskutime ndokush para se të futemi në procesin e vendimmarrjes? Nuk ka.

Më lejoni t'i theksoj këshillat juridike për vendimmarrje e cila ishte edhe një nga pyetjet e deputetes Vjosa Osmani.

Në bazë të nenit 81, paragrafi 3 të Rregullores së Kuvendit, ndryshimi i Rregullores së Kuvendit miratohet me 2/3 e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Miratimi i vendimit për formimin e 4 komisioneve të përhershme dhe 10 komisioneve funksionale nënkupton edhe ndryshimin e nenit 69 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores së Kuvendit, me të cilin nën janë caktuar 4 komisione të përhershme dhe 12 komisione funksionale.

Do të thotë, të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin...

(Ndërhyrje)

Më fal, të lutem! Unë i lexova këshillat juridike të cilat i kam po ashtu nga administrata dhe në të njëjtën kohë afër jush e keni edhe profesorin e nderuar, i cili ka përvojë 14-vjeçare.

Si do që të jetë, edhe një herë, nëse ka nevojë do ta lexoj për të gjithë, por nuk besoj se ka nevojë.

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e propozim-vendimit për numrin dhe strukturën e komisioneve parlamentare.

Në sallë janë të pranishëm 98 deputetë.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarojnë.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon? Nuk ka abstenim.

(Ndërprerje)

Konstatohet se me 58 vota për, 32 kundër dhe asnjë votë abstenim, Kuvendi nuk ka vendosur për komisionet parlamentare, për arsye se nuk e ka pasur shumicën e mjaftueshme.

Prandaj, seanca përfundoi, kurse për seancën e radhës do t'ju njoftojmë. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*